



Human Rights Review Panel

Buletini informativ # 2 – dhjetor 2012 – janar 2013

- Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (PShDNj) ka mbajtur seancën e 14^{të} në Prishtinë
- Katja Domenik është emëruar anëtare e re e Panelit
- Debati në Radio Televizionin e Kosovës (RTK)
- Vizita e studentëve të shkallës master në PShDNj
- Fushata informative

Seanca e 14^{të} e rregullt e PShDNj-së

PShDNj-ja ka mbajtur seancën e 14^{të} të rregullt nga data 14 deri më 16 janar 2013 në Prishtinë. Është konstatuar se para fillimit të seancës kanë qenë 21 ankesa të pazgjidhura, ku katër prej tyre ka qenë të gatshme për t'u shqyrtuar nga Paneli.

Paneli ka vendosur njëzëri se dy prej këtyre ankesave ishin të papranueshme ([Faik Ibishi kundër EULEX-it \(2012-07\)](#) dhe [Mufail Halili kundër EULEX-it \(2012-08\)](#)). Për më tepër, Paneli për të parën ka marrë vendim në rishqyrtimin e një lënde. Në lëndën [Y. kundër EULEX-it \(2011-28\)](#) ankuesi ka parashtruar tri dokumente shtesë pas marrjes së vendimit fillestar për papranueshmëri me 15 nëntor 2012. Këto tri dokumente fillimisht ishin dërguar tek Paneli, mirëpo nuk kanë arritur aty për arsye teknike, pa fajin e ankuesit.

Pas marrjes së këtyre dokumenteve, Paneli ka vendosur ta rishqyrtoj pranueshmërinë e ankesës sipas Rregullës 42 të Rregullores së vet të punës. Paneli konkludoj njëzëri se dokumentet në fjalë nuk kanë ndikuar në mënyrë thelbësore në vendimin për të shpallur ankesën të papranueshme.

Vendimet e Paneli do t'ju dërgohen ankuesve dhe shefit të Misionit të EULEX-it (ShM). Për më tepër, Paneli ka vendosur që ta përcjell një lëndë tek ShM-ja për informata dhe vërejtje të tjera. Vendimet do të publikohen në kohën e duhur në faqen e internetit të Panelit pasi të përkthehen në gjuhën shqipe dhe serbe.

Paneli ka shfrytëzuar mundësinë që të ndryshoj dhe miratoj Rregulloren e vet të punës, e cila gjendet në faqen e internetit të Panelit: www.hrrp.eu/reference-documents.php.

Seanca e radhës e Panelit është caktuar të mbahet nga 8 – 11 prill 2013 në Prishtinë.

Nëse mendoni që jeni viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it, mund të parashtroni ankesë pranë Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Ankesa duhet të parashtrohet brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së dyshuar, dhe duhet që jetë me shkrim.

Për më shumë informata vizitoni www.hrrp.eu.

Tabela e jurisprudencës

PShDNj-ja ka përpunuar një tabelë të hollësishme të jurisprudencës, duke i theksuar shumë çështje që lidhen me juridiksionin e vet, çështje procedurale si dhe lidhur me meritat e ankesave. Tabelën mund ta shihni përmes faqes së internetit të Panelin në <http://www.hrrp.eu/jurisprudence.php>

Katja Dominik është emëruar anëtare e re e Panelit

Znj. Katja Dominik, me shtetësi gjermane, ka studiuar drejtësinë dhe gjuhët sllave në Universitetin e Goettingen-it në Gjermani, ku ka diplomuar në vitin 1996.

Znj. Dominik së pari ka punuar si gjykatëse në Gjykatën e Qarkut në Dusseldorf, ku është specializuar në lloje të ndryshme të ligjit penal. Më pas, ajo u bë zëvendëse kryetare në dhomën penale për krime të rënda kapitale dhe krime ekonomike të Gjykatës së Qarkut.

Znj. Dominik është emëruar gjykatëse ndërkombëtare në EULEX (Kosovë) në tetor të vitit 2011, ku më pas ajo u caktua në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës, ku merret me raste të krimeve të luftës të një profili të lartë, vrasje, korrupsion dhe trafikim të qenieve njerëzore. Pasi shërbimit një vjeçar si anëtare zëvendësuese e PShDNj-së, ShM-ja ka emëruar znj. Dominik anëtare të plotë në janar të vitit 2013.



Vizita e studentëve në PShDNj

Si në vitet e mëparshme, studentët nga programi evropian i shkallës master për të drejtat e njeriut dhe demokratizim (E.MA) kanë vizituar Panelin në zyrat e tij në Prishtinë më 17 janar 2013. Studentët janë njoftuar nga anëtarja e Panelit znj. Verginia Ruseva-Micheva lidhur me mandatin, punën dhe jurisprudencën e Panelit.

Takimi vazhdoj me një diskutim të hollësishëm lidhur me historikun e Panelit dhe sfidat e tanishme të tij. Pikat e tjera të ngritura me interes kanë qenë pavarësia e Panelit në raport me EULEX-in, si dhe ndikimi dhe rëndësia e tij për një rol të mundshëm që mund ta ketë si model në misionet e ardhshme sipas Politikës së përbashkët për mbrojtje dhe siguri të Bashkimit Evropian.



Nga e majta në të djathtë: Verginia Micheva-Ruseva (anëtare e Panelit), John Ryan (zyrtar i lartë ligjor), Joanna Marszalik (zyrtare ligjore)

Debati televiziv rreth respektimit të të drejtave të njeriut në Kosovë

Më 10 dhjetor 2012, anëtarja e Panelit znj. Verginia Micheva Ruseva ka marrë pjesë në një debat televiziv në Radio Televizionin e Kosovës rreth temës “Respektimi i të drejtave të njeriut në Kosovë”, ku ka folur rreth mandatit, procedurave dhe punës së Panelit. Përveç Avokatit të Popullit të Kosovës, në diskutim kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë dhe Zyrës së Komisionarit të Lartë për të drejtat e njeriut.




Pjesëmarrësit e debatit televiziv: nga e majta në të djathtë: Nikola Gaon, Sami Kurteshi, Resul Sinani (moderator), Nedim Osmanagic, Verginia Micheva-Ruseva

Raporti vjetor dhe fushata informuese

Paneli ka publikuar [raportin e vet vjetor](#) për vitin 2012 me datën 4 shkurt 2013. Raporti përshkruan hollësisht punën e Panelit rreth lëndëve gjatë periudhës raportuese, fushatën e vet informuese dhe çështje të tjera. Ndër të tjerash raporti gjithashtu paraqet sfidat e ardhshme në kontekst të rikonfigurimit të EULEX-it, ku po ashtu ofron rekomandime.

Për më tepër, Paneli më 29 janar 2013 ka rinisur fushatën e vet informuese në Mitrovicën e veriut, ku ka mbajtur një takim me znj. Zlata Radovanovic-in, bashkërenduese e zyrës për Kosovë dhe Metohi në Mitrovicë.

Statistikat rreth lëndëve - janar 2013



Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut - Sekretariati

Rruga: Rrustem Statovci nr. 29 – 10000 Prishtinë – Kosovë

Tel: +386 (0) 43 78 2125 - Fax: +381 (0) 38 78 7711

Për t'u abonuar në buletin informativ shkruani në: office@hrrp.eu

www.hrrp.eu